

Komuna e Gjakovës

Pasqyrat Financiare për vitin qe përfundon me 31 Dhjetor 2009

(te bashkangjitur raportin e pavarur te auditorit)



KPMG Albania Sh.p.k. - Kosovo Branch
14, Sulejman Vokshi Street
Pristina
Kosovo

Telephone +381 38 246 771
Telefax +381 38 246 772
E-mail al-kosovo@kpmg.com
Internet www.kpmg.al

Raporti i Audituesve të Pavarur

Për Kuvendin Komunal
Komuna e Gjakovës, Kosovë

Prishtine, 10 Qershor 2010

Ne ishim të angazhuarë për t'i audituarë pasqyrat financiare të Komunës së Gjakovës (Komuna), të cilat përbehen nga pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2009, një krahasim të buxhetit me shifrat aktuale, dhe një përmbledhje e politikave më të rëndësishme kontabël dhe shënimet te tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik Bazuar në Paranë e Gatshme ("SNKSP") *Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Bazuar në Paranë e Gatshme* dhe me Udhëzimin Administrativ Nr. 20/2009 *Raportimi Vjetor i Organizatave Buxhetore*. Kjo përgjegjësi përfshin: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e një kontrolli të brendshëm të përshtatshëm për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Përgjegjësia e Audituesve

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Për shkak të çështjeve të përshkruara në paragrafin 1 te Bazës për Refuzim për të Dhënë Opinion, ne nuk ishim në gjendje të siguronim evidencë auditimi të përshtatshme dhe të mjaftueshme për të bazuar një opinion auditimi.

Bazat për Refuzim të Opinionit

- 1 Komuna duhet të mbajë lista të pagesave nga palët e treta. Për shkak të natyrës së regjistrimeve të mbajtura në kontabilitet dhe në sistemet operacionale në lidhje me pagesat nga palët e treta, si dhe në mungesë të kontrolleve alternative të zbatuara nga menaxhmenti, ne nuk ishim në gjendje të kryenim teste auditimi të përshtatshme dhe të mjaftueshme për verifikimin e plotësisë së pagesave nga palët e treta të njohura për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2009.
- 2 Komuna nuk ka paraqitur në pasqyrat financiare të përgatitura më datë dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2009 disa shënime të kërkuara nga SNKSP *Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Bazuar në Paranë e Gatshme* dhe nga Udhëzimi Administrativ Nr. 20/2009 *Raportimi Vjetor i Organizatave Buxhetore*. Në veçanti, sa më poshtë mungonin ose nuk ishin shpalosur në mënyrën e duhur në pasqyrat financiare:
 - Neni 14. Pranimet Kapitale nuk është e kompletuar.
 - Neni 16, Shënimi 29 Detyrimet Kontingjente nuk është e kompletuar.

Si pasojë, ne nuk ishim në gjendje të siguroheshim në mënyrë të arsyeshme mbi plotësinë dhe përputhshmërinë rregullatorë të informacionit financiar të paraqitur nga pasqyrat financiare të Komunës më datë dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2009.

3 Komuna nuk ka shpalosur ndonjë shumë për pronat, objektet dhe pajisjet në shënimin 27 të pasqyrave financiare. Për më tepër, ka disa mungesa dhe pasiguri që ndikojnë raportimin financiar të Komunës për pronat, objektet dhe pajisjet si më poshtë:

- Komuna nuk ka mbajtur një regjistër gjithëpërfshirës të pronës, fabrikës dhe pajisjeve. Në veçanti Komuna nuk ka përfshirë në regjistrin e mjeteve fikse ndonjë rruge, sistem ujësjellësi apo kanalizimi. Si rezultat i kësaj, Komuna nuk ka përgatitur një regjistër gjithëpërfshirës të pronës së paluajtshme, duke përfshirë dokumentacionin e pronësisë së këtyre pronave dhe informacioneve në lidhje me statusin e regjistrimit në emër të Komunës në Kadastër apo në Gjykatë.
- Për arsye të mungesës së dokumenteve mbështetëse për matjen e një pjese të madhe të pronave, Komuna ka tentuar t'i masë këto prona me vlerën e tyre të drejtë, bazuar në një vlerësim të bërë në vitin 2007, nga një komitet i brendshëm i vlerësimit. Regjistrimi i pasurive të Komunës nuk ka përfunduar dhe asnjë vlerësim apo shpalosje në pasqyrat financiare nuk është bërë për pasuritë e regjistruara në vitin 2009.

Si pasojë e natyrës së regjistrimeve dhe mungesave të tjera të shpjeguara më sipër, ne nuk mundëm të përcaktojmë çfarë rregullimesh mund të ishin të nevojshme për informacionin financiar të paraqitur në pasqyrat financiare të Komunës.

4 Informacionet krahasuese për vitet 2008 dhe 2007 nuk janë complete dhe nuk janë të sakta. Në veçanti, ato janë lënë jashtë pasqyrave dhe nuk janë prezantuar në mënyrën e duhur në pasqyrat financiare:

- Informacionet krahasuese për vitin 2007 në Nenin 10 *Pasqyra e Pranimeve dhe pagesave në Para te Gatshme* nuk barazohet me Shënimin 9.
- Informacionet krahasuese për vitin 2007 për grandet dhe të hyrat vetanake të bartura nga vitet e kaluara në Nenin 11 *Raporti i Ekzekutimit të Buxheti* nuk është complete dhe e saktë.

Meqenëse pasqyrat financiare për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2007 dhe 31 Dhjetor 2008 morën një refuzim për të dhënë opinion, treguesit krahasues të përshkruar më sipër mund të jenë me anomali materiale.

Refuzim për të Dhënë Opinion

Për shkak të rëndësisë së çështjes së trajtuar në paragrafin 1 të Bazës për Refuzim për të Dhënë Opinion ne nuk shprehim ndonjë opinion mbi këto pasqyra financiare.

Rishikimi i përputhshmërisë

Përveç auditimit të pasqyrave financiare, është planifikuar dhe kryer një rishikim i përputhshmërisë për të shprehur një konkluzion me siguri të kufizuar nëse në të gjithë aspektet materiale, aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e reflektuara në pasqyrat financiare janë në përputhje me autoritetet që i qeverisin ato. Natyra, koha dhe masa e punës për përputhshmërinë ishin të kufizuara krahasuar me atë të hartuar për të shprehur një opinion me siguri të arsyeshme për pasqyrat financiare.

Përgjegjësia e Audituesve

Përgjegjësia jonë është të shprehim një konkluzion bazuar në rishikimin tonë. Puna jonë është kryer në përputhje me ISSAI 4200 *Udhëzime mbi Auditimin e Përputhshmërisë Lidhur me Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Këto parime kërkojnë që ne të zbatojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe kryejmë rishikimin për të arritur një siguri të kufizuar nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e reflektuara në pasqyrat financiare janë në përputhje, në të gjithë aspektet materiale me autoritetet që i qeverisin ato.

Një rishikim është i kufizuar kryesisht në procedura analitike dhe intervista, dhe për këtë jep më pak siguri se një auditim. Ne nuk kemi kryer një auditim, dhe për këtë arsye, ne shprehim konkluzionin tonë në formën e një sigurie të kufizuar, e cila është konsistente me punën e kufizuar që ne kemi kryer për këtë rishikim përputhshmërie.

Ne besojmë se evidenca që ne kemi marrë është e përshtatshme dhe e mjaftueshme për të dhënë një bazë për konkluzionet tona.

Konkluzion për Përputhshmërinë

Bazuar në punën tonë të përshkruar në këtë raport, aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e reflektuara në pasqyrat financiare që kemi parë gjatë rishikimit, janë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me autoritetet që i qeverisin ato, përveç se:

Në Shënimin 25 të pasqyrave financiare Komuna ka prezantuar obligimet e papaguara deri me 31 Dhjetor 2009, në vlerë prej EUR 2,209 mijë. Pagesat totale në vitin 2009 së bashku me faturat e papaguara deri me 31 Dhjetor 2009 e kalojnë buxhetin final vjetor të aprovuar në shumën prej EUR 1,617 mijë. Kjo nuk barazohet me Nenin 13.1 të Udhëzimit Administrativë Nr. 20/2009, i cili thotë që: *“Organizatata buxhetore nuk janë të lejuara të hyjnë në obligime që tejkalojnë buxhetin e aprovuar vjetor”*.

Çështjet tjera

Ne tërheqim vëmendjen për sa më poshtë:

- 1 Burimi parësor i informatave të besueshme për përgatitjen e pasqyrave financiare është Free Balance. Por meqë Free Balance nuk është përdorur për t'i regjistruar pagesat nga palët e treta, pronën, fabrikën dhe pajisjet ose obligimet e papaguara, ai nuk mund të përdoret për të përpiluar pasqyra financiare gjithëpërfshirëse.

- 2 Megjithëse zyrtari i lartë financiar ka nënshkruar deklaratën për prezantimin e pasqyrave financiare, Komuna nuk ishte në gjendje të përgatiste një draft final të pasqyrave financiare në gjuhën serbe deri në fund të auditimit tonë.
- 3 Komuna nuk ka implementuar një sistem faturimi automatik dhe gjithëpërfshirës, dhe nuk mban lista apo llogari të veçanta për të gjithë debitorët e saj për detyrime të lidhura me taksa të ndryshme. Vetëm arkëtimet në para të gatshme nga të hyrat regjistrohen. Megjithëse llogaritë e arkëtueshme nuk kërkohen të shpalosen në pasqyrat financiare, mungesa e saktësisë dhe plotësisë së tyre do të ndikojë në të hyrat që Komuna mund të fitojë dhe në aftësinë për të përgatitur një buxhet të besueshëm dhe të saktë, për të raportuar një raport të saktë arkëtueshmërie, dhe për të monitoruar arkëtimet e të hyrave vetanake në baza kohore.
- 4 Komuna nuk ka mbajtur lista të pagesave nga palët e treta. Evidencat e disponueshme dhe kontrollet e zbatuara nga menaxhmenti për tu siguruar se pagesat nga palë të treta prezantohen dhe menaxhohen në përputhje me legjislacionin përkatës dhe përdoren për qëllimin e synuar nga legjislacioni, ishin të limituara.
- 5 Ne identifikuam një numër mospërputhjesh me Ligjin Nr. 2003/17 'Ligji për Prokurimin Publik në Kosovë' (ndryshuar). Këto mospërputhje lidheshin me procedura të kërkuara të cilat nuk ishin kryer dhe dokumentuar nga Komuna.
- 6 Megjithëse Komuna mund të jetë e përfshirë në disa raste të vogla ligjore dhe është e mundur që pagesa të parasë së gatshme të kërkohen në të ardhmen e afërt, Komuna nuk ka kryer ndonjë proces formal që mund të sigurojë informacion të plotë, të përshtatshëm dhe të besueshëm për regjistrimin e provizioneve dhe detyrimeve kontingjente.

KPMG Albania Shpk Kosovo Branch

KPMG Albania Sh.p.k. – Dega Kosovë
Rruga: Sulejman Vokshi Nr 14
Prishtinë
Kosovë

Shënim

- 1 Sqarime të mëtejshme për rekomandimet dhe përgjigjet e menaxhmentit për këto sugjerime janë përfshirë në Shtesën 1 të këtij raporti.
- 2 Një sqarim për format e ndryshme të modifikimeve të një opinionit auditimi është përfshirë në Shtesën 2 të këtij raporti.

1 Të përgjithshme

1.1 Auditimi për vitin 2009

KPMG Albania Sh.p.k. – Dega Kosove (“KPMG”) është emëruar për te ushtruar auditimin e pasqyrave financiare te Komunës së Gjakovës (“Komuna”) të përgatitura në bazat e parasë së gatshme në pajtim me SNKSP *Raportimi Financiar në para të gatshme*, për vitin që mbaron më 31 dhjetor 2009.

Këshilla jonë në këtë dokument kufizohet në konkluzionet e specifikuar në vazhdim dhe është bazuar në plotësinë dhe saktësinë e fakteve të paraqitura më poshtë, supozimeve dhe prezantimeve. Nëse ndonjë prej fakteve, supozimeve apo prezantimeve të përmendura nuk është tërësisht i plotë ose i saktë, atëherë është e domosdoshme që ne të informohemi menjëherë, duke qenë se pasaktësia dhe mungesa e plotësisë mund të kenë një efekt material në konkluzionet tona. Për dhënien e këshillës sonë, ne mbështetemi në dispozitat relevante të legjislacionit aktual në Kosovë, rregullave dhe interpretimeve juridike dhe administrative të saj. Këto autoritete i nënshtrohen ndryshimeve, në mënyrë retroaktive dhe/ose prospektive dhe ndryshime të tilla mund të kenë ndikim në vlefshmërinë e konkluzioneve tona. Ne nuk do të përditësojmë këshillat tona për ndryshimet ose modifikimet e mëvonshme të legjislacionit dhe rregulloreve, ose të interpretimeve juridike apo administrative të tyre.

1.2 Pasojat

Raporti ynë është planifikuar të përfshijë rekomandime të dobishme që mund të ndihmojnë në përmirësimin e politikave të kontabilitetit dhe sistemit të kontrollit dhe kontabilitetit të Komunës si dhe në shmangien e dobësive që mund të çojnë në humbje materiale ose në gabime.. Është detyrimi juaj të ndërmerri veprimet e nevojshme për korrigjimin e dobësive dhe nëqoftë se ju dështoni në të, ne nuk do të mbajmë përgjegjësi për humbjet apo gabimet që mund të ndodhin si rezultat.

1.3 Përjashtimi i pasojave

Siç kemi rënë dakord, ju gjithashtu keni pranuar që për arsye të rëndësishme në punën tonë të informacionit dhe përfaqësimeve që na janë dhënë nga Komuna, drejtuesit e saj, punonjësit apo agjentët ju, përveç rasteve të neglizhencës, keqbesimit ose pakujdesive të paramenduara, nuk do të na quani përgjegjës ose fajtorë për ndonjë humbje ose të tjera pasoja në qoftë se informacioni i rëndësishëm për punën tonë na është mbajtur apo fshehur me qëllim, ose na është paraqitur në mënyrë mashtruese.

1.4 Struktura e këtij raporti

Çdo kategori e vëzhgimeve është e përshkruar në një faqe të veçantë. Për çdo vëzhgim struktura është: *vëzhgimi dhe statusi aktual nëse është e aplikueshme, rreziku, rekomandimi dhe përgjigja e menaxhmentit.*

2 Çështjet e ngritura gjatë vitit aktual

2.1 Përgatitja e Pasqyrave Financiare

2.1.1 Vëzhgimi

Informacion parësor ne te cilin Komuna mbështetet për përgatitjen e Pasqyrave Financiare është Free Balance. Megjithatë, pasi që Free Balance nuk është përdorur për t'i regjistruar pagesat nga palët e treta, pronën, fabrikën dhe pajisjet ose faturat e papaguara, Free Balance nuk mund te përdoret për të përpiluar pasqyra financiare krahasuese.

Megjithëse Kryetari i Komunës ka nënshkruar Deklaratën për prezantimin e pasqyrave financiare, Komuna nuk ka përgatitur një draft të pasqyrave financiare në gjuhën angleze dhe serbe përpara fillimit te auditimit. Gjatë periudhës së auditimit ne shpenzuam kohe dhe burime të konsiderueshme në asistimin e Komunës për të përmirësuar prezantimin e pasqyrave financiare në gjuhën angleze. Për më tej, Komuna nuk ishte në gjendje të dorëzonte një variant final të pasqyrave financiare në serbisht deri në fund të auditimit tonë.

Edhe pse Komuna mund te jete e përfshirë ne ceshtje te vogla gjyqësore dhe është e mundur qe te ketë dalje te parasë te gatshme ne te ardhmen e afërt, Komuna nuk ka ndonjë procedure formale qe do te siguronte informacion të plotë, të përshtatshëm dhe të besueshëm për te regjistruar provizionet për detyrimet kontingjente.

Si pasojë e dobësive të përmendura më sipër përmendën shpalosje jo te plota ose të pasakta në pasqyrat financiare.

- Shënimi 14. Pranimet Kapitale nuk është e kompletuar
- Neni 16, Shënimi 29 Detyrimet kontingjente nuk është e kompletuar
- Faturat e papaguara (detyrimet)
- Mund te ketë pagesa te konsiderueshme nga palët e treta, për shembull raste kur një pale tjetër si një ministri apo donator i huaj blejnë/kontribuojnë një pasuri për përdorim nga Komuna, dhe kjo për shkak se nuk është e regjistruar ne Free Balance nuk është e prezantuar ne pasqyrat financiare.
- Informacionet krahasuese për vitin 2007 në Nenin 10 *Deklarata mbi pranimet dhe pagesat me para të gatshme nuk barazohet me Shënimin 9.*
- Për më tepër, informacionet krahasuese per grante dhe të hyra vetanake të bartura prej vitit të kaluar të prezantuara ne Nenin 11 Raporti i ekzekutimit te buxhetit nuk është e kompletuar.

2.1.2 Rreziku

Mangësitë në kontrollat e brendshme në lidhje me sistemin e raportimit financiar mund ta ekspozojnë Komunën ndaj rreziqeve dhe gabime për sa vijon:

- Plotësia dhe saktësia e informacionit financiar;
- Integritet i te dhënave;
- Ruajtja e pasurive, dhe

- Mungesa e regjistrimit te pagesave nga pale te treta mund te rezultojë ne pasuri/shërbime te përdorura pa qira nga pale te tjera, te ndryshme nga Komuna.

2.1.3 Rekomandimi

Përgatitja e pasqyrave financiare të Komunës duhet të përmbajë procedura dhe mjete të përcaktuara për tu siguruar se informacioni i kërkuar është regjistruar, procesuar, përmbledhur dhe raportuar drejt në pasqyrat financiare.

2.1.4 Përgjigja e menaxhmentit

- Sa i përket Pranimeve Kapitale nga palët e treta – Ministritë, është problem kompletimi i dokumentacionit përkatës sepse me këto dokumente disponojnë Ministritë, qasja e Komunës është e pa mundur dhe mungojnë dokumentet për regjistrimin e Pranimeve Kapitale nga palët e treta – Ministritë. Pagesat për investime kapitale bëhen direkt nga Ministritë, në vend se këto donacione të barten përmes sistemit të Free Balance në gjendjen e Komunës dhe të bëhet e mundur regjistrimi dhe evidentimi i pronës komunale si donacione.
- Informacioni lëshimit teknik të bërë në krahasimin e nenit 10 dhe shënimit 9 të vitit 2007 Tani kemi përparime që shihen në kompletimin e tabelave financiare në vitin 2008,2009
- Informacionet krahasuese për grande dhe të hyra vetanake të bartura prej vitit të kaluar të prezantuara ne Nenin 11 për vitin 2008 Raporti i ekzekutimit te buxhetit nuk është e kompletuar, përmirësimet janë bërë në vitin fiskal 2010 që vërehen në tabela financiare.

2.2 Prona, fabrika dhe pajisjet

2.2.1 Vrojtimi

Komuna nuk ka mbajtur një regjistër gjithëpërfshirës të pronave, objekteve dhe pajisjeve në posedim të saj. Për më tepër, Komuna nuk ka përgatitur një listë të detajuar dhe gjithëpërfshirëse të patundshmërive, përfshirë këtu edhe dokumentacionin mbi pronësinë për këto pasuri, dhe informacion për statusin e regjistrimit në emrin e Komunës në Kadastër ose në Gjykatë.

Komuna ka krijuar një komitet për regjistrimin dhe vlerësimin e pasurive. Ky komitet nuk përbëhet nga vlerësues të certifikuar dhe vlerat në listë nuk janë mbështetur me një raport vlerësimi. Regjistrimi i pasurive të Komunës është ende në proces.

Ne nuk na është ofruar ndonjë evidencë për inventarin fizik me 31 Dhjetor 2009 dhe si pasojë verifikimi i regjistrave kontabël me numërimin fizik të pasurisë ishte i pamundur.

Për shkak të natyrës së të dhënave të tilla, Komuna nuk ishte në gjendje të:

- shpalosë informacionin e kërkuar për patundshmëritë, pronat dhe pajisjet në pasqyrat financiare me 31 Dhjetor 2009, 31 Dhjetor 2008 dhe 31 Dhjetor 2007.
- të na sigurojë rakordimin e informacionit të regjistruar në kontabilitet me tabelat e vlerësimit ose me ndonjë analizë tjetër, para aprovimit të pasqyrave financiare.

2.2.2 Rreziku

Mungesa e një regjistri gjithëpërfshirës të pronës, objekteve dhe pajisjeve dobëson kontrollet e brendshme mbi këto të fundit dhe mund të çojë deri në keqpërdorim të pasurive dhe në mos identifikimin e këtyre keqpërdorimeve në kohën e duhur. Për më tepër, menaxhmenti mund të humbasë kohë dhe përpjekje për të identifikuar detajet dhe vlerën e mbartur të aseteve gjatë proceseve vendim-marrëse.

Komuna mund të mos jete në gjendje të kontrollojë shfrytëzimin momental të pasurisë së saj nga palët e treta dhe si pasojë mund të mos i mbledh të hyrat nga qiraja nga këto patundshmëri.

Si pasojë e natyrës së regjistrimeve të saj dhe mungesës së vlerësimit të duhur të pasurive, Komuna mund të mos jetë në gjendje të pajtohet me kërkesat e raportimit.

2.2.3 Rekomandimi

Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se Komuna do të konsiderojë si më poshtë:

- Të mbaje një regjistër gjithëpërfshirës të pronës, objekteve dhe pajisjeve.
- Të përfshijë burime shtese në regjistrimin dhe vlerësimin e pasurive të Komunës. Përfshirja e vlerësuesve të pavarur dhe certifikuar është e rekomandueshme dhe praktika më e mirë në rast të tilla.

- Te beje numërimin e rregullt fizik për tu siguruar mbi ekzistencën e pasurive dhe kushteve të tyre dhe të barazojë rezultatet e numërimit me të dhënat në kontabilitet dhe regjistër.
- Te beje përpjekje shtese në lidhje me konfirmimin e pronësisë dhe regjistrimin e patundshmërive..

2.2.4 Përgjigja e menaxhmentit

- Ofrimi i evidencës për inventarin fizik me 31 Dhjetor 2009 është bërë nga ana e Komunës por ka mbetur të evidentohen edhe Rrugët, Kanalizimet dhe pronat kontestuese ku Komuna ka krijuar një komitet për regjistrimin dhe vlerësimin e pasurive të mbetura.
- Shpalosja e informacionin e kërkuar për patundshmëritë, pronat dhe pajisjet në pasqyrat financiare me 31 Dhjetor 2009 është bërë që do të thotë në kemi implementuar sugjerimet e auditorit për vitin 2007 dhe 2008
- Të gjitha të dhënat janë të regjistruara sipas faturave të blerjes ndërsa donacionet dhe pasuritë e vjetra janë vlerësuar nga komisioni Komunal i Vlerësimit

2.3 Te hyrat

2.3.1 Vrojtimi

- *Sistemi i faturimit.* Ekziston vetëm një sistem automatik i faturimit për tatimin në pronë. Pjesa e faturimit për shërbimet tjera të Komunës nuk është e regjistruar. Për këto te hyra regjistrohen vetëm arkëtimet e parave.
- *Mbledhja e të hyrave.* Përveç tatimit mbi pronën, qirasë dhe hyrave nga licencat për biznese, menaxhmenti i Komunës nuk mban regjistra ose lista për të gjithë debitorët e saj në lidhje me taksa të ndryshme. Pa të dhëna të detajuara, të mjaftueshme dhe të sakta për debitorët, Komuna nuk është në gjendje të përgatisë një buxhet të saktë dhe të besueshëm, të raportojë për koeficientet e mbledhshmërisë së të hyrave, apo të përcjellë mbledhjen e të hyrave vetanake në kohën e duhur.
- *Te hyrat nga lejet për biznese.* Komuna nuk ka marrë nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë numrin e përditësuar të bizneseve aktive në Komunë. Kështu që, biznese joaktive ose të mbyllura mund të ngarkohen me takse, derisa bizneset e reja aktive mund të mos taten fare. Sipas shënimeve që Komuna ka për vitin 2009, gjithsej biznese të regjistruara kanë qenë 2,800, prej të cilave 2,300 kanë qenë aktive, ndërsa kanë paguar lejen për punë vetëm 668. Për më tepër, vetëm 12% e faturimeve në 2009 ka arritur të faturohet. Duke llogaritur edhe borxhet e viteve të kaluara, në fund të vitit 2009, borxhet totale për leje pune kanë arritur EUR 775,494.
- *Harmonizimi i të hyrave.* Nuk ka pas harmonizime të të hyrave vetanake në mes të departamentet të financave dhe departamenteve tjerë operacional për vitin 2009. Kjo nuk ka qenë e mundur të bëhet për arsye se departamentet nuk mbajnë shënime në lidhje me arkëtimet që bëhen në sektorët e tyre.
- *Te hyrat nga qiraja.* Ne e kemi identifikuar që kontratë qiraje që janë nënshkruar në vitin 2003 dhe asnjëherë nuk është ripërtëri. Përveç kësaj, disa kontrata tjera të zgjedhura nga ne, kanë tarifa më të ulëta për njësi sesa çmimet për njësi të dhëna në tariforin e Komunës. Vetëm 49% e të arkëtueshmeve nga qiraja, duke përfshirë edhe të arkëtueshmet për vitet paraprake janë mbledhur në vitin 2009. Për më tepër, komuna ka identifikuar 223 prona të Komunës të cilat janë duke u përdorur nga qytetarët ose bizneset dhe të cilat nuk janë faturuar në vitin 2009.
- *Të hyrat nga participimet e qytetarëve për shërbime shëndetësore,* 90% e shërbimeve shëndetësore janë ofruar pa pagesë gjatë vitit 2009, vetëm 10% janë faturuar dhe janë arkëtuar nga taksapaguesit. Përqindja e shërbimeve pa pagesë është shumë e lartë duke konsideruar se vetëm një numër i kufizuar gëzojnë të drejtën e shërbimeve shëndetësore falas, siç janë fëmijët, të moshuarit, veteranët e luftës dhe invalidët e luftës.
- *Licencat për pranimin teknik të objekteve.* Komuna nuk ka mbajtur një regjistër të faturave të lëshuara në vitin 2009 dhe nuk ka bërë harmonizimin e të hyrave të mbledhura me departamentin e financave. Ne nuk kemi qenë në gjendje të verifikojmë se cila ka qenë shumta e faturuar dhe cila ka qenë shumta e arkëtuar e këtyre shërbimeve të kryera nga Komuna.
- *Të hyrat nga shërbimet e inspektimit (veterinaria, pijet alkoolike, sanitaria etj).* Komuna nuk ka mbajtur një regjistër të faturave të lëshuara për vitin 2009 (UNIREF). Gjithsej të hyrat e arkëtuara në vitin 2009 nga lëshimi i licencave për bizneset është EUR 50,097, për veterinarin, pijet alkoolike dhe sanitarin. Në vitin 2009, kanë qenë më shumë se 2,300 biznese

aktive, dhe taksa për një leje ka qenë prej EUR 30 deri EUR 500 (varësisht prej madhësisë dhe llojit të biznesit). Duke marrë parasysh numrin e bizneseve aktive dhe shumën, dhe nëse për të gjitha bizneset do të aplikohet tarifa me e ulët (2300 x 30) ne do të prisnin të hyra rreth EUR 69 mijë.

- *Të hyrat nga njësit tjerë.* Të hyrat e arkëtuara nga njësit tjera, si p.sh në shkolla, qendra kulturore, spitale dhe konvikte, nuk kanë qenë të harmonizuara me departamentin e financave ose për me tepër nuk kanë qenë fare të raportuara në Komunë (grumbullimet e parave të gatshme në shkolla).

2.3.2 Rreziku

Meqenëse për të arkëtueshmet nuk kërkohet shpалosja ne pasqyrat financiare, mungesa e saktësisë dhe plotësisë do të ndikojë te hyrat qe Komuna mund te fitojë.

Kontrolle jo te duhura dhe te pamjaftueshme ne lidhje me te hyrat dhe softuerët dhe sistemin e faturimit, rrisin rrezikun e manipulimit te dhënave dhe keqpërdorimit te informacionit. Një sistem i tille mund të çojë në faturim dhe të hyra jo të plota.

Regjistrimi manual dhe mungesa e lidhjes se sistemit te faturimit dhe sistemit te kontabilitetit ne mënyre automatike, e ekspozon Komunën ndaj rrezikut shtese te gabimit. Për me tepër, kjo shkakton kosto shtese për mbajtjen e te dhënave, rishikimin dhe barazimin e informacionit.

Një liste e detajuar dhe e përditësuar e tatim paguesve, bizneseve aktive dhe debitorëve te gjeneruar nga sistemi është me rëndësi te veçante ne situatën e tanishme ku komunat nuk e regjistrojnë secilin transaksion individual ne Free Balance. Si pasoje, përveç tatimit mbi pronën, Thesari dhe Komuna, nuk kanë një liste te detajuar te gjeneruar nga sistemi i kontabilitetit ose sistemi i faturimit. Si rezultat i kësaj, nuk është e mundur te bëhen barazimet e nevojshme ose analiza sipas debitorëve.

2.3.3 Rekomandimi

Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se Komuna do të ndërmarrë hapa për te përmirësuar sistemin e kontabilitetit dhe te faturimit ne mënyre qe te siguroj kontrolle te sigurta, eficiente dhe efektive ne faturim dhe te hyra. Përmirësimi i procedurave te lidhura me keto sisteme do ti mundësonte menaxhmentit te monitorojë dhe menaxhojë rreziqet e mëdha dhe te sigurojë qe vendimet ne lidhje me buxhetimin, planifikimin dhe mbledhjen e te hyrave janë bartur siç duhet. Ne i rekomandojmë komunës te konsideroj pikat si ne vijim:

- Implementimin e një sistemi te faturimit qe përfshin detaje te përditësuar për paguesit, adresën e tyre te tanishme, historinë dhe normën e mbledhjes se te hyrave nga këta pagues. Qasje ne informacion te tille duhet te kenë vetëm një numër te limituar personash dhe të autorizuar nga menaxhmenti.
- Të vendosë dhe të kontrollojë nga qendra tarifat dhe normat e taksave ne sistem ne mënyre qe të llogarisë dhe gjenerojë automatikisht faturat. Ky gjenerim i faturave gjithashtu duhet te autorizohet dhe te rishikohet.
- Të ekzistojë një lidhje automatike ne mes te sistemit te faturimit dhe sistemit te kontabilitetit ne mënyre qe informacioni te procesohet automatikisht ne librin kryesor te kontabilitetit.

- Të ushtrojë barazime të rregullta midis dy sistemeve në periudha të rregullta për të gjitha llojet e të hyrave. Në rastet kur ka diferencë, ato duhet të hulumtohen dhe të zgjidhen brenda afatit të caktuar.
- Të lidhen automatikisht zyrat e faturimit me operacionet dhe të bëhen barazime të rregullta në mes tyre, për rastet ku faturimi direkt lidhet me shërbimet nga zyrat operacionale. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në rastet kur ekzekutohet një numër i madh i transaksioneve.

2.3.4 Përgjigja e menaxhmentit

- Ekziston sistemi automatik i faturimit për tatimin në pronësi dhe dhënia e Uniref-ve për të gjitha të hyrat komunale. Barazimet e të hyrave Komunale bëhen në baza mujore si dhe bëhen raportime mujore. Jemi në proces të regjistrimit të Uniref-ve në ato drejtori që mungon kjo evidencë.
- Komuna ka marrë të gjitha masat e nevojshme që në vitin fiskal 2010 të mënjanojë pengesat në inkasimin e të hyrave – obligimeve të mbetura nga qytetarët dhe Bizneset Komunale me formimin e komisionit për vlerësimin e inkasimit të hyrave komunale.

2.4 Shpenzimet

2.4.1 Vëzhgimi

Detyrimet e papaguara (detyrimet)

Neni 13.1 i Urdhëresës Administrative Nr 20/2009 mbi Raportimin Vjetor të Organizatave Buxhetore thotë që: “Për të gjitha mallrat dhe shërbimet të pranuar pa marrë parasysh kategorinë ekonomike, organizata duhet të paguaj për to deri në fund të viti 2009. Ne kemi vërejtur që Komuna ka prezantuar faturat e papaguara në lidhje me mallrat dhe shërbimet në Nenin 13, Shënimi 24i Pasqyrave Financiare për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2009.

Për më tepër, Neni 13.1 i Urdhëresës Administrative Nr 20/2009, thotë që: *Organizatave Buxhetore nuk janë të lejuara të hyjnë në obligime që kalojnë buxhetin e aprovuar vjetor. Ne kemi vërejtur që Komuna ka raportuar obligimet e saja (faturat e papaguara) me 31 Dhjetor 2009, të cilat kur iu shtohen shpenzimeve të komunës kalojnë buxhetin vjetor të aprovuar, që rrjedhimisht qon në papajtueshmëri me Urdhëresën Administrative të lartcekur.*

Procedurat e prokurimit

Gjatë punës në auditimin e komunës në lidhje me procedurat e prokurimit, ne kemi vërejtur disa çështje që bien ndesh me ligjin e prokurimit në fuqi. Çështjet në fjalë kanë të bëjnë më rastet e mëposhtme:

- Lënda me nr të prokurimit: 632 08 071 511 – nuk ka pasur kërkesë për inicim të procedurave të prokurimit.
- Lëndët me nr të prokurimit : 632 09 052 521, 632 09 053 521- Kërkesa për zotim të mjeteve nuk është aprovuar.
- Lëndët me nr të prokurimit: 632 09 061 521, 632 08 070 521, 632 08 071 511, 632 09 025 521, 632 09 048 521, 632 08 062 521 – menaxheri i projektit nuk është caktuar nga menaxheri i prokurimit.
- Lëndët me nr të prokurimit: 632 09 061 521, 632 08 070 521, 632 08 071 511, 632 09 025 52, 632 09 048 521, 632 09 072 521, 632 09 053 521, 632 09 014 521, 632 09 052 521- anëtarët e komisionit për vlerësimin e tenderëve nuk janë caktuar. Në disa raste asnjë nga anëtarët e komisionit vlerësues nuk është caktuar.
- Lëndët me nr të prokurimit: 632 09 061 521, 632 08 071 511, 632 08 094 521 – Formularët e vlerësimit nuk janë të plotësuar fare. Për më tepër për njërin nga rastet (632 09 061 521) kryetari i komunës ka propozuar që fitues të jetë kompania e cila edhe e ka marrë punën, derisa komisioni për vlerësim nuk ka bërë vlerësimin ashtu si parashihet me ligjin mbi prokurimin publik.
- Lënda me nr të prokurimit: 632 08 094 521 – Dhënia e kontratës nuk është shpallur në gazetë.
- Lëndët me nr të prokurimit: 632 09 048 521, 632 08 057 521, 632 08 070 521, 632 08 070 521 – Kontrata janë nënshkruar para se mjetet të zotoheshin.
- Lëndët me nr të prokurimit: 632 08 094 521, 632 08 102 521 – nuk dihet kur projektet kanë përfunduar për arsye se nuk është bërë pranimi teknik final i projektit.
- Lënda me nr të prokurimit: 632 08 102 521, 632 08 028 511 - Faturat 14/09 date 24 Prill 09; 18/09 datë: 13 Maj 09; 1/09 datë 20 Prill 09 nuk kanë grancionin e ekzekutimit.
- Lënda me nr të prokurimit: 632 08 070 521 – Kontraktori është paguar për EUR 18,814.06 më shumë sesa që është kontraktuar. Nuk ka miratim për punë shtesë nga APP dhe si

rrjedhojë nuk ka as aneks kontratë gjë që është në kundërshtim të plotë me ligjin e prokurimit publik.

- Gjatë auditimit të komunës ne kemi vërejtur planin e prokurimit nuk është hartuar në baze të ndonjë paramasë dhe parallogarite, kështu që të gjitha shumat janë parashikuar pa pasur bazë në ndonjë faktor ose llogari mbështetëse.
- Gjithashtu ne kemi vërejtur që disa projekte janë ekzekutuar ose janë duke u ekzekutuar dhe të cilat nuk kanë qenë të planifikuara me planin e prokurimit për vitin 2009.

Pagat dhe mëditjet

- Komuna nuk ka një sistem të listës së pagave, ku mund të përdoret si burim i besueshëm i informacionit për të mbështetur shifrat në pasqyrat financiare. Në vend të kësaj komuna ka përdorur listat e pagave të të dhënave nga Ministria e Shërbimeve Publike.
- Nga mostra që ne kemi zgjedhur jone, ne katër raste mungonin format e vlerësimit. Ne nuk gjetëm përshkrimin e punës dhe kodin e etikës për të gjithë rastet e zgjedhjes sonë dhe gjithashtu vendimet për rekrutimin e stafit dhe formën e deklaramit të stafit që i dërgohet Ministrisë së Shërbimeve Publike për vendet e reja të lira.

2.4.2 Rreziku

Megjithëse gjetjet e lartpërmendura nuk kanë efekt material në pasqyrat financiare, mungesa e komunikimit në kohe dhe aprovimet nga autoritetet përkatëse ose mungesa e dokumentacionit në dosjet e prokurimit mund të çojë deri në mos përputhje me Ligjet dhe kërkesat e Rregulloreve.

Duke tejkualuar buxhetin vjetor është shkelje e ligjit dhe mund të qoj Komunën në një gjendje josolvente, ku ajo mund të dështoj ti paguaj furnizuesit e saj të culet mund më vonë mund të ngrenë padi ndaj Komunës.

Duke tejkualuar buxhetin vjetor tregon që Komuna e ka tejkualuar shumën që mund të shpenzohet dhe ka anashkualuar ligjin. Ky tren mund të sjell komplikime në të ardhmen për pagesat ndaj furnitorëve dhe mosmarrëveshje gjyqësore me palët e dëmtuara.

2.4.3 Rekomandimi

Ne rekomandojmë që Kryetari të sigurohet se Komuna do të ndërmarre hapa të mëtejshme për përmirësimin e kontroleve mbi shpenzimet dhe pagesat dhe të jetë në pajtueshmëri të plote me ligjet dhe kërkesat e rregulloreve lokale.

2.4.4 Përgjigjja e menaxhmentit

- Lënda me nr të prokurimit: 632 08 071 511 –ka pasur kërkesë për inicim të procedurave të prokurimit me datën 10/7/2008 me rastin e rishpalljes së tenderit nuk ka pasur kërkesë të re sepse vlen kërkesa e parë.
- Lëndët me nr të prokurimit : 632 09 052 521, 632 09 053 521- Kërkesa për zotim të mjeteve është aprovuar me datën 8/6/2009 dhe 3/6/2009
- Kandidatet janë të caktuar nga Drejtori i Drejtorisë dhe caktimi është e bazuar në bazë të kërkesës së zyrës së prokurimit.

- Lëndët me nr të prokurimit: 632 08 071 511, 632 08 094 521 – Formularët e vlerësimit janë të plotësuar në letër te thjeshtë por jo në formularin zyrtar. Për sa i përket lëndës (632 09 061 521) Firmën Terra Systems-Austria për hyrje ne tregun Kosovar ka nënshkruar marrëveshje dhe është pajtuar me Kryetarin e Komunës datë:19/6/02009 për ndërtimin e rrugës Rakovin Kralan gjatësi 5.8 km me kompensim, dhe pranon ndërtimin e rrugës Dobrosh –Nivokaz-Molliq 3.8 km donacion (pa kompensim) për te cilën lende ekziston marrëveshja e nënshkruar nga dy palët. (Ne tender është njëra nder firmat me te lira).
- Lënda me nr të prokurimit: 632 08 094 521 –njoftimi për dhënie të kontratës është shpallur ne gazetat Zëri dhe Koha ditore me dt. 18.11.2008.
- Lëndët me nr të prokurimit: 632 09 048 521, 632 08 057 521, 632 08 070 521, 632 08 070 521- në të gjitha rastet e cekura më lartë të gjitha zotimet janë bërë para lidhjes së kontratës, për të cilat lëndë ekzistojnë zotimet .
- Lëndët me nr të prokurimit: 632 08 094 521, 632 08 102 521 –pranimi teknik i këtyre lëndëve është bërë në vitin 2010.
- Lënda me nr të prokurimit: 632 08 102 521,632 08 028 511 - Faturat 14/09 date 24 Prill 09; 18/09 datë: 13 Maj 09; 1/09 datë 20 Prill 09, Egziston sigurimi i egzekutimit që nga data 09.01.2009, dhe sigurimi i ekzekutimit për lëndën e dytë me 29.04.2009.
- Lënda me nr të prokurimit: 632 08 070 521 – Kontraktuesi është paguar për EUR 18,814.06 më shumë sesa që është kontraktuar. Gjate përpilimit të raportit financiar është vënë re gabimi i lëshuar nga Organi Mbikëqyrës dhe menjëherë është kontaktuar me organin mbikëqyrës dhe firmën kontraktuese, për kthimin e mjeteve financiare të paguara më tepër. Firma kontraktuese ka bërë kthimin e mjeteve financiare në vitin 2010 dhe është bere barazimi financiar dhe për këtë kemi dëshmitë (Shkresat zyrtare te dërguara dhe dokumentin financiar te kthimit te mjeteve financiare).

2.5 Auditimi i brendshëm

2.5.1 Vrojtimi

Në vitin 2009 auditori i brendshëm ka bërë vetëm një raport të auditivit. Sipas raportit që ne kemi parë, auditori i brendshëm nuk ka mbuluar të gjitha fushat e auditimit sipas planit të auditivit. Për më tepër, auditori i brendshëm nuk ka bërë auditime të vazhdueshme në mënyrë që të arrijë të kryej funksionin e tij si auditorë i brendshëm.

Në vitin 2010, Komuna nuk ka themeluar Komitetin e Auditimit, nuk ka pasure Komitetin e Auditimit ne vitin 2009, Komiteti është themeluar ne vitin 2010 dhe është i përbërë nga shtate anëtare te cilët janë anëtare ne Kuvendin Komunal.

2.5.2 Rreziku

Mungesa e një Komiteti Auditimi dhe e një ndjekje të rekomandimeve të bëra nga auditorët e brendshëm, rrit rrezikun e dështimit të kontroleve të brendshme. Për më tej, nuk lejon që funksionet të cilat mbulohen zakonisht nga një Komitet Auditimi të kryhen me pavarësinë e duhur nga Komuna.

2.5.3 Rekomandimi

Kryetari i Komunës duhet të konsiderojë krijimin e një funksioni te Auditimit te brendshëm dhe një Komiteti Auditimi me anëtarë që kanë eksperiencë të lidhur me raportimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Komiteti i Auditimit duhet të vendosë politika dhe procedura të duhura për të siguruar një standard të lartë ‘udhëheqje të korporatës’. Komiteti i Auditimit duhet të rishikojë statusin aktual dhe të propozojë veprime për përmirësime në sa më poshtë:

- Kontabiliteti dhe proceset e raportimit financiar të Komunës;
- Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm të implementuara nga Menaxhimi;
- Proceset e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm;
- Përputhshmëria, raportimi dhe strukturat e kontrollit në gjithë Komunën të tilla që sigurojnë përputhje me kërkesat financiare, rregullatore dhe ligjore;
- Plani i auditit të brendshëm dhe ndjekja e gjetjeve të auditit të brendshëm.

2.5.4 Përgjigja e menaxhmentit

Komuna ka bërë hapat e nevojshme në këtë drejtim. Ka formuar Komitetin e Auditimit.

3 Çështjet e ngritura vitin e kaluar

Gjatë auditimit të Pasqyrave Financiare të Komunës për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2009, ne kemi bërë pesë rekomandime kryesore, dy prej të cilave janë pjesërisht të zgjidhura gjatë vitit, përderisa të tjerat kanë mbetur të pazgjidhura deri me 31 Dhjetor 2009. Shiko më poshtë statusin që kanë në këtë vit gjetjet e viti të kaluar:

1. Përgatitja e pasqyrave financiare
Çështja lidhur me mungesën e disa shpalosje të caktuara në Pasqyrat Financiare, mbetet e pazgjidhur, përveç disa shpalosjeve të caktuar që janë shtuar në pasqyra financiare. Statusi aktual i kësaj gjetje është diskutuar në seksionin 2.1 e kësaj letre.
2. Prona, fabrika dhe pajisjet
Megjithëse Komuna ishte në gjendje të identifikonte shumicën e pasurive të saja dhe t'i regjistroj ato ne Free Balance, procesi nuk ka arritur të finalizohet deri ne fund të vitit 2009, sepse këto pasuri nuk kanë qenë të vlerësuara nga një vlerësues i pavarur profesional. Statusi aktual i kësaj çështje është diskutuar ne seksionin 2.2 të kësaj letre.
3. Të hyrat
Gjetjet e viti 2008 që kanë të bëjnë me të hyrat vetanake, mbasin të pazgjidhura, ndërsa statusi i tyre për vitin aktual diskutohet ne seksionin 2.3 të kësaj letre.
4. Shpenzimet
Statusi në vitin aktual i gjetjeve që kanë të bëjnë me shpenzimeve është diskutuar në seksionin 2.3 të kësaj letre.
5. Auditimi i brendshëm
Kjo çështje është pjesërisht është e zgjidhur dhe gjendja e saj në vitin aktual është diskutuar në seksionin 2.5 të kësaj letre.

Shtesa 2

Forma të ndryshme të Opinioneve të Auditimit të përdorua nga Zyra e Auditorit Gjeneral në Raportin e Auditimit Vjetor për vitin 2009

(Marrë nga ISSAI 4000)

9. Një opinion auditimi normalisht jepet në një format standard, dhe lidhet me pasqyrat financiare në tërësi, duke evituar kështu nevojën për të sqaruar gjerësisht se çfarë qëndron pas tij, por duke bërë të mundur për lexuesit nëpërmjet llojit të tij, të kuptuarit e përgjithshëm të domethënies së tij. Natyra e fjalëve do të ndikohet prej kuadrit ligjor për auditimin, por përmbajtja e opinionit do të jetë e nevojshme të tregojë qartë nëse është i pakualifikuar apo i kualifikuar dhe, nëse është i kualifikuar, është i kualifikuar për disa aspekte apo është një opinion kundër (paragrafi 14) ose një refuzim për të dhënë opinion (paragrafi 15).

10. **Një opinion i pakualifikuar** jepet kur audituesi është i kënaqur në cdo aspekt material për sa vijon:

(a) Pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur baza kontabël të pranueshme dhe politika të cilat janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme;

(b) Pasqyrat janë në përputhje me kërkesat statutoare dhe rregulloret përkatëse;

(c) Sipas njohurisë së audituesit mbi njësinë e audituar, pamja e paraqitur nga pasqyrat financiare është e qëndrueshme; dhe

(d) Pasqyrat financiare përmbajnë shpalosjet e duhura të informacionit për të gjitha çështjet materiale.

11. **Tërheqje e vëmendjes.** Në disa rrethana audituesi mund të mendojë se lexuesi nuk do të jetë në gjendje të kuptojë drejt pasqyrat financiare nëse atij nuk i tërhiqet vëmendja për çështje të rëndësishme apo të pazakonta. Si parim i përgjithshëm, audituesi që jep një opinion të pakualifikuar nuk u referohet aspekteve të pasqyrave financiare në opinion, nëse ky do keqinterpretohet si një kualifikim. Me qëllim evitimin e dhënies se kësaj përshtypje, referimet që kanë kuptimin e “tërheqjes së vëmendjes” paraqiten në një paragraf të veçantë prej opinionit. Megjithatë, audituesi nuk duhet të përdorë një tërheqje vëmendje për çështje të cilat lidhen me mungesën e shpalosjes së duhur të informacionit në pasqyrat financiare, dhe as si një alternativë apo zëvendësuese të kualifikimit të opinionit.

12. Një auditues mund të **mos jetë në gjendje të shprehë një opinion të pakualifikuar nëse** ekziston ndonjë prej rrethanave të mëposhtme dhe sipas gjykimit të audituesit efekti i tyre në pasqyra financiare është ose mund të jetë material:

(a) Ka pasur kufizim të qëllimit të auditimit;

(b) Audituesi konsideron nëse pasqyrat janë të paplota ose keqinterpretuese, ose nëse ka një shmangie të pajustificuar nga standardet kontabël të pranuar; ose

(c) Ka pasiguri që prekë pasqyrat financiare.

13. **Opinion i kualifikuar.** Kur audituesi nuk është dakord ose është i pasigurt për një ose më shumë zëra të veçantë të pasqyrave financiare, të cilët janë materiale, por jo thelbësore për të kuptuar pasqyrat, duhet dhënë një opinion të kualifikuar. Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm për auditimin, subjekt ky i një deklaratë të qartë dhe koncize për çështjet për të cilat audituesi ka kundërshtim apo të cilat krijojnë pasiguri që sjellin kualifikimin e opinionit. Përcaktimi sasior i efektit financiar që vjen prej pasigurisë apo kundërshtimeve nga ana e audituesit, i ndihmon përdoruesit e pasqyrave, megjithëse ky nuk është gjithmonë i mundur apo i rëndësishëm.

14. **Opinion kundër.** Kur audituesi nuk është në gjendje të krijojë një opinion mbi pasqyrat financiare të marra në tërësi, për shkak të kundërshtive kaq thelbësore sa e dëmtojnë prezantimin e pozicionit në masën që një opinion i kualifikuar vetëm për disa aspekte do të ishte i papërshtatshëm, jepet një opinion kundër. Formulimi i një opinioni të tillë bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë të paraqitura në mënyrë të drejtë, duke specifikuar qartë dhe shkurt të gjitha çështjet e kundërshtuara. Përsëri, përcaktimi sasior i efektit financiar ndihmon përdoruesit e pasqyrave, nëse një gjë e tillë është praktikë dhe e rëndësishme.

15. **Refuzim për të dhënë Opinion.** Kur audituesi nuk është në gjendje të krijojë një opinion mbi pasqyrat financiare të marra në tërësi, për shkak të një pasigurie apo një kufizimi të qëllimit, kaq thelbësor sa një opinion i kualifikuar vetëm për disa aspekte do të ishte i papërshtatshëm, jepet një refuzim për të dhënë opinion. Formulimi i një refuzimi të tillë bën të qartë se nuk mund të jepet një opinion, duke specifikuar qartë dhe shkurt çështjet e pasigurta.

16. Per SAI është e zakonshme që të jepet një raport i detajuar që sqaron opinionin në rrethana kur nuk është e mundur të jepet një opinion i pakualifikuar.

II. DECLARATION REGARDING PRESENTATION OF FINANCIAL STATEMENTS

To: **Lulzim Ismajli, Director of Treasury**

From: **Permanent Secretary (Chief Executive Officer)**

In our opinion, the attached financial statements and the notes to these statements for the year ended on 31 December 2009 have been prepared in accordance with the International Public Sector Accounting Standards "Financial Reporting Under the Cash Based Accounting", adhere to all reporting requirements of the Law on Public Finance and Accountability 03/L-048 and are based on properly maintained financial records.

This declaration is provided in connection with the presentation of the Kosovo General Budget financial statements of the budget organizations for the year ending on December 31, 2009.

We confirm, to the best of our knowledge and belief, that:

There have been no irregularities involving management or employees which could have had a material effect on the financial statements.

The information provided and presented in the financial statements regarding the identification of funds and their expenditure related to the Kosovo Consolidated Budget is complete and accurate.

The information regarding collection of revenues is accurate.

There are no bank accounts related to the KCB other than the bank accounts specified in the financial statements and this specification is complete and accurate as of December 31, 2009.

There has been no non-compliance with requirements of regulatory authorities that could have a material effect on the financial statements in the event of non-compliance.

There are no (legal) claims pending that could have a material effect on the financial statements.

All liabilities, both actual and contingent, and all guarantees given to third parties have been recorded and/or disclosed, as appropriate.

All loans to external parties have been recorded and/or disclosed, as appropriate.

There have been no events subsequent to period end which require adjustment of or disclosure in the financial statements or Notes thereto.

Municipalities must send their reports to the Budget and Finance Committee in the Municipal Assemblies.

In our opinion, the attached the financial statements give a true and fair presentation of the finances and financial transactions for the year ended on 31 December 2009 of Municipality of Gjakova.

Date:

Signature and stamp:

Chief Executive Officer

Date:

Signature and stamp:

Chief Financial Officer

Komuna e Gjakovës

Neni 9. Pasqyra e pranimeve dhe pagesave ne para te gatshme për vitin qe përfundon me 31 Dhjetor 2009

(Shumat ne mije EUR, përveç kur thuhet ndryshe)

	Notes	2009			2008			2007		
		Llogaria e Vetme e Thesarit ('LIVTh')			Llogaria e Vetme e Thesarit ('LIVTh')			Llogaria e Vetme e Thesarit ('LIVTh')		
		Buxheti i Konsoliduar i Kosovës ('BKK')	THV	Pagesat nga palët e treta	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës ('BKK')	THV	Pagesat nga palët e treta	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës ('BKK')	THV	Pagesat nga palët e treta
	€'000	€'000	€'000	€'000	€'000	€'000	€'000	€'000	€'000	
Pranimet										
Ndarjet nga Fondi i Përgjithshëm	2	10,819	2,843	-	7,907	2,529	-	6,919	1,450	-
Ndarjet nga Fondi me Qëllime te Dedikuara	2	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Grantet e Përcaktuara te Donatoreve	3	356	-	-	176	-	-	65	-	-
Pranimet tjera	4	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Totali i Pranimeve		11,175	2,843	-	8,083	2,529	-	6,984	1,450	-
Pagesat										
<i>Operacionet</i>		-	-	-						
Pagat dhe Mëditjet	5	6,708	94	-	5,786	17	-	5,217	21	-
Mallrat dhe Shërbimet	6	1,222	265	-	1,178	501	-	1,000	331	-
Shërbimet Publike	7	522	-	-	552	24	-	491	51	-
		8,452	359	-	7,516	542	-	6,708	403	-
<i>Transferet</i>										
Transferet dhe Subvencionet	8	-	325	-	-	357	-	-	225	-
<i>Shpenzimet Kapitale</i>										
Prona, Ndërtesa dhe Pajisjet	9	2,367	2,159	-	391	1,630	-	211	822	-
Pagesat tjera	10	356	-	-	176	-	-	65	-	-
Totali i Pagesave		11,175	2,843	-	8,083	2,529	-	6,984	1,450	-

Komuna e Gjakovës
Neni 10. Raporti i ekzekutimit te buxhetit
Për vitin qe përfundon me 31 Dhjetor 2009

(Shumat ne mije EUR, përveç kur thuhet ndryshe)

		2009				2008	2007	
		Buxheti fillestar (Ndarja)	Buxheti Final (Ndarja)	Realizimi	Ndryshimi	Realizimi	Realizimi	
		A	B	C	D=C-B	E	F	
Shënimi							€'000	€'000
Hyrja e parasë se gatshme ne llogari te thesarit								
Tatimi	11	-	-	-	-	-	-	
Granti i përgjithshëm		10,805	10,865	10,819	(46)	7,907	6,919	
Te hyrat vetanake	12,28	802	2,518	2,080	(438)	2,017	1,450	
Te hyrat vetanake te bartura nga viti i kaluar	12,28	820	820	763	(57)	512	-	
Grantet dhe ndihmat	13	-	407	356	(51)	176	-	
Pranimet kapitale	14	-	-	-	-	-	-	
Fondin i privatizimit		-	-	-	-	-	-	
Te tjera		-	-	-	-	-	65	
		12,427	14,610	14,018	(592)	10,612	8,155	
Daljet e parasë se gatshme nga llogarite e thesarit								
Pagat dhe mëditjet	17	6,728	6,839	6,802	(37)	5,803	5,238	
Mallrat dhe Shërbimet	18	1,351	1,531	1,487	(44)	1,679	1,331	
Shërbimet publike	19	519	523	522	(1)	576	542	
Transferet dhe Subvencionet	20	200	350	325	(25)	357	225	
Shpenzimet kapitale	21	3,629	4,960	4,526	(434)	2021	1,033	
Fondi i privatizimit	22	-	-	-	-	-	-	
Shpenzime tjera	23	-	407	356	(51)	176	65	
Totali i pagesave i bere nga BKK nëpërmes te LIVTh		12,427	14,610	14,018	(592)	10,612	8,155	

Komuna e Gjakovës

Neni 11. Shënimet e pasqyrave financiare 31 Dhjetor 2009

(Shumat në mijëra EUR, përveç nëse thuhet ndryshe)

1. Politikat Kontabël

a) Bazat e përgatitjes së Pasqyrave Financiare

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik ('SNKSP') Bazuar në Paranë e Gatshme *Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Bazuar në Paranë e Gatshme* dhe me Udhëzimin Administrativ Nr. 20/2009 *Raportimi Vjetor i Organizatave Buxhetore*.

Politikat kontabël janë aplikuar në mënyrë konsistente gjatë gjithë periudhës raportuese.

b) Entiteti raportues

Pasqyrat financiare janë për një entitet në sektorin publik: Komuna e Gjakova ("Komuna").

Komuna nuk operon me llogarinë e saj bankare. Qeveria ushtron funksionin e thesarit qendror që administron shpenzimet me para të gatshme që bën Komuna gjatë gjithë vitit financiar. Këtij funksion i referohemi si "Llogaria e Vetme e Thesarit" ose "LIVTh". Pagesat e bëra për Komunën në këtë llogari janë të shpalosura në kolonën e Llogarisë së Thesarit në Pasqyrën e Pranimeve dhe Pagesave me para të gatshme si dhe pasqyrat tjera financiare.

c) Pagesat nga Palët e Treta

